

4071

REPUBLIKA E SHQILISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 4071/E.DIMIT

V E N D I M

PER RIREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me daten 13.05.1994 une gjyqtarja e gjykates se rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Muharrem Buredini, Dhimiter Kolovani e Dhame Daka per riregjistrimin si person juridik dhe

V E R D I T

Se kerkuesit Muharrem Buredini, Dhimiter Kolovani dhe Dhame Daka kane paraqitur dokumentacionin per riregjistrimin si person juridik, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "KONUDA" SHPK me seli ne Berat, lagja 30 vjetori, me kapital themeltar 100 000 leke, per nje periudhe mbi 10 vjet, per te ushtruar veprimtarine saj si: punime dheu, murature, betoni, b/armeje te zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore e kompletimi ne instalimet e nevojshme per to, punime restaurimi, punime te shtresave te rrugëve, ujeshjellesa, kanalizime mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal, me administrator

PER KETO ARSYE

Ne base te Aedit 64 te ligjit 7607 date 28.11.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D I T

Riregjistrimin si person juridik te firmes "KONUDA" ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "KONUDA" SHPK me seli ne Berat, lagja 30 vjetori, me kapital themeltar 100 000 leke, per nje periudhe mbi 10 vjet, per te ushtruar veprimtarine e saj si: punime dheu, murature, betoni, b/armeje te zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore e kompletimi ne instalimet e nevojshme per to, punime restaurimi, punime te shtresave te rrugëve, ujeshjellesa, kanalizime, mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal, me administrator

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte

GJYQZARE

Florina Topu
Fajz

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 4071/2

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 06 06.2005, une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit Muharrem Nuredini per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1 date 01.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "KONUDA"sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr. 4071, dt. 13.05.1994 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "KONUDA" sh.p.k me ortak Muharrem Nuredini, Dhimiter Kolovani dhe Dhame Daka, me administrator Dhimiter Kolovani

Me vendimin nr.4701/1, date 19.03.2003 nga kjo shoqeri largohet z. Dhimiter Kolovani dhe shoqeria "KONUDA" shpk mbetet me dy ortake Muharrem Nuredini dhe Dhame Daka , me kuota te barabarta secili nga 50 % dhe me administrator z.Muharrem Nuredini, me seli ne Berat.

Me vendimin nr.1 te Asamblese se Ortakeve date 01.06.2005 eshte vendosur :

1. Te caktojme si ekspert kontabel te autorizuar z. Dhimo Dundo me numer license nr.8, date 11.01.2000 per shtesen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .
2. Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitimin e vendimit nr. 1, dt. 01.06.2005 te Asamblese se Ortakeve ne regjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregtar te e vendimit nr.1, dt. 01.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "KONUDA"sh.p.k per caktimin e ekspertit kontabel te autorizuar per shtesen e kapitalit .

Te behen ndryshimet perkatese duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
BLERINA MUÇA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 4071 / Vendimit

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

N_e T_{irane} sot me date 18 03.2002 une
gjytare e gjykates se shkalles se pare T_{irane}
Urule Cepo mora ne shqyrtim kerkesen e
paraqitur nga kerkuesi Dhimiter K_{olovani} dhe Dhame
Dake e M_{aharrem} N_{uredini} per depositimin prane rregjistrit
tregetar te Gjykates te vendimit te asamblese se
ortakeve te shoqerise tregetare " KONUDA " shpk dhe

K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr. 4701 date 15.05.1994 eshte
rregjistruar si person juridik shoqeris tregetare
KONUDE " shpk .

M_e vendimin e asamblese te ortakeve te kesaj
shoqeris eshte vendosur largimi nga kjo shoqeri i
ortakut Dhimiter K_{olovani} duke ja shitur kuota e
kapitalit ortakeve qe ngelen ne kete shoqeri s. M_{aharrem}
N_{uredini} dhe Dhame Daka, duke ngelur kapitali i shoqerise
100 . 000 leke te dy ortaket M_{aharrem} N_{uredini} 50 %
dhe Dhame Daka 50 %. Emerimin si administrator te
shoqerise te s. M_{aharrem} N_{uredini}, shkarkimin si administrator
te shoqerise te s. Dhimiter K_{olovani}.

K_{erkesa} eshte e drejte dhe si e tille duhet
pranuar.

PER KETO ARSYE

N_e baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe
te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A


P_{ranimin} e kerkeses.

D_{epositimin} prane rregjistrit tregetar te
Gjykates te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise
tregetare "KONUDE " shpk nr. 2 date 27.2.2002, ku eshte
vendosur : largimi nga kjo shoqeri e ortakut Dhimiter
K_{olovani}

duke ju shitur kuota e kapitalit dy omtakeve qe ngelen ne kete shoqeri z. M. harrem N. redini dhe Dhame Daka, shkarkimin si administrator te shoqerise te z. Dhimiter Kolovani, dhe emerimin si administrator te shoqerise te z. M. harrem N. redini.

Udhërohet zyra e rregjistrimit tregëtar të beje ndryshimet perkatëse ne kollonen vet germa C si dhe te behet ndarja me vize te kuge nga njeri rregjistrim tek tjetri.

GJYQTBARE

1. P. N. C. P.


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 4071/3 i vendimit

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me date 05.07 2005 une M. Nuredini me detyren e gjyqtarit ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise tregtare "Konuda" sh.p.k, z. Muharrem Nuredini, per depozitimin ne rregjistrin tregtar te vendimit nr. 2 date 10.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise, ne te cilin eshte vendosur per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise dhe ndryshimin e statutit,

K O N S T A T O V A

Se me vendimin Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, nr.4071, date 13.05.1994, eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregtare "KONUDA" sh.p.k. Me vendimin, nr.1, date 01.06.2005, ju kerkua gjykates caktimi i nje eksperti kontributesh per shtimin e kapitalit themeltar dhe gjykata e caktoi ate me vendimin e saj nr. 4071/2, date 06.06.2005. Asambleja e Jashtezakonshme ka marre vendimin nr. 2 date 10.06.2005 ne te cilin ka vendosur:

1. Miratimin e raportit te ekspertit te kontributeve z Dhimo Dundo, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 34.220.000 leke, nepermjet perfshirjes se fitimeve te mbartura, fitimit te ushtrimit dhe rezervave te tjera, te paraqitura ne llogarite vjetore te ushtrimit 2004. Shtesa e kapitalit themeltar ndahet ne 34.220 pjese me vlere nominale te barabarte 1.000 leke secila, aq sa ka qene vlera nominale e pjeseve ekzistuese.
3. Pjeset e reja do te perfitoen nga ortaket ne perpjestim me te drejtat e meparshme dhe perkatesisht nga, z. Muharrem Nuredini 17.110 pjese ose 17.110.000 leke dhe z Dhame Daka 17.110 pjese ose 17.110.000 leke.
4. Shtimin e rezerves ligjore me 5% te fitimeve te pashpermdara ose 1.001.935 leke.
5. Ndryshimin e nenit 7-te statutit te shoqerise qe tani lexohet si me poshte:
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 34.320.000 leke, i ndare ne 34.320 pjese me vlere nominale 1.000 leke secila dhe zoterohet nga ortaket:
 - Muharrem Nuredini, zoteron 17.160 pjese kapitali e barabarte me 17.160.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
 - Dhame Daka, zoteron 17.160 pjese kapitali e barabarte me 17.160.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
6. Depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar.

P E R K E T O A R E S Y E :

Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij Nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar".


V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitimim ne rregjistrin tregtar te vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "KONUDA" sh.p.k., nr.2 date 10.06.2005 per:

1. Miratimin e raportit te ekspertit te kontributeve z Dhimo Dundo, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 34.220.000 leke, nepermjet perfshirjes se fitimeve te mbartura, fitimit te ushtrimit dhe rezervave te tjera, te paraqitura ne llogarite vjetore te ushtrimit 2004. Shtesa e kapitalit themeltar ndahet ne 34.220 pjese me vlere nominale te barabarte 1.000 leke secila, aq sa ka qene vlere nominale e pjeseve ekzistuese.
3. Pjeset e reja do te perftohesh nga ortaket ne perpjestim me te drejtat e meparshme dhe perkatesisht nga, z. Muharrem Nuredini 17.110 pjese ose 17.110.000 leke dhe z. Dhame Daka 17.110 pjese ose 17.110.000 leke.
4. Shtimin e rezerves ligjore me 5% te fitimeve te pashpermdara ose 1.001.935 leke.
5. Ndryshimin e nenit 7-te te statutit te shoqerise qe tani lexohet si me poshte:
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 34.320.000 leke, i ndare ne 34.320 pjese me vlere nominale 1.000 leke secila dhe zoterohet nga ortaket:
 - Muharrem Nuredini, zoteron 17.160 pjese kapitali e barabarte me 17.160.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
 - Dhame Daka, zoteron 17.160 pjese kapitali e barabarte me 17.160.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
6. Depozitimim e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar.

Te behen ndryshimet perkatese duke i ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.
Ndaj vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE


K O N T R A T E
P E R K R I J L I M I N E S H O Q E R I S E M E P E R G J E G J E S I
T E K U F I Z U A R " K O N U D A " S H P K

Ne Tiranë sot me datën 1994 ne qytetaret:

Dhimiter Koloçani, i biri i _____, lindur me 1943, banues ne Berat, lagja 30 vjetori, shtetas shqiptar,
Muharrem Nuredini, i biri i _____, lindur me 1947, banues ne Berat, shtetas shqiptar.

Dhame Daka, i biri i _____, lindur me 1949, banues ne Berat.

te deklaruar ortak vendosem sa me poshte:

Neni 1

te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "KONUDA"
" KONUDA " SHPK

Neni 2

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj si: punime dheu, murat
re, betoni, beton armeje te zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile, in-
dustriale, turistike, bujtesore e kompletimi me instalimet e nevojshme per t
punime restaurimi, punime te shtresave te rrugeve, ujesjellesa, kanalizime
mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal.

Neni 3

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria dote bleje, marre me q
ra dhe mund te ndertoje ambiente pune, njesi e lokale duke bashkepunuar me
persona fizike e juridike, vendas e te huaj. ro keshtu ne te do te punesoje
specialiste e punonjes duke respektuar legjislacionin per marredheniet e
punes ne Re publike e Shqiperise.

Neni 4

Qendra e shoqerise eshte ne Berat, lagja "30 vjetori". Ajo mund te
hape vendqendrim te tjera te dyta, filiale perfaqesi, agjenci, ne tere
territorin e RSH dhe memratim te organeve kompetente ligjore edhe jashte
Atdheut.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne shumen 100 000 leke i ndare
ne kuota te barabarta,

Neni 6

Shoqeria ka nje kolegjatje te veprimtarise se saj me 10 vjet. Ajo
mund te shperbhet per cdo arsye apo shkak.

Neni 7

Shoqeria dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar, ne baze te kesaj kontrate dhe statutit te shoqerise qe i bashkalidhet kesaj kontrate e qe eshte pjese perberese e saj.

Neni 8

Per administrimin e shoqerise emerohet

Neni 9

Organet drejtuese te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar jane Asambleja e ortakëve dhe administratorët e zgjedhur prej saj.

Per kapitalin themeltar do te hapet libri i llogarise, ku do te shenohen kontributet e secilit ortak. Po keshtu shoqeria do te kete e perdore dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithë kerkesave te tjera te domosdoshme per veprimtari normale te saj.

Neni 11

Qasarrveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim do te zgjidhen ne rruge gjyqesore nga gjykata e rrethit tirane.

Neni 12

Kjo kontrate u perpilua ne prani te ortakëve duke shprehur ne te vullnetin e lire te tyre.


Kontrata u perpilua ne 4 kopje, me fuqi te barabarta secila.

ORTAKËT THEMELUES


Dhimitër Kolovani



Muhammed Kuređini



Dhame Daka



S T A T U T

i shoqerise ndertimore "KONUDA"

EMERTIMI - OBJEKTI - ORGANIZIMI - KOHEZGJATJA

Neni 1

Eshte krijuar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "KONUDA" SHRK e ortakeve Dhimiter Kolovani, Muharrem Nuredini, Dhame Daka.

Neni 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ne fushen e ndertimit si: punime dheu, mursture, betoni, beton armeje te zakonshme, punime shembjesi ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore e kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime restaurimi, punime te shtresave te rrugeve, ujesjellesa, kanalizime, mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal.

Neni 3

Shoqeria mund te marre pjese dhe te bashkepunoje me shoqeri te tjera qe kane si objekt te njejten veprimtari ose qe lidhen direkt apo terthore me te.

Neni 4

Shoqeria e ka seline e vet ne Berat, lagja 30 vjetori, nr Ajo mund te cele edhe vendqendrimet e tjera te dyta, filiale, agjenci, perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes dhe me lejen e organeve kompetente edhe jashte Shqiperise.

Neni 5

vendbanimi i perhershem i ortakeve eshte ne Berat.

Neni 6

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj mbi 10 vjet. Shoqeria mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cdo arsye apo shkak.

K A P I T A L I

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne shumen 100 000 mije leke e ndare ne kuota te barabarta.

Neni 8

Transferimi i kuotave te kapitalit themeltar qofte ne jete si dhe pas vdekjes do te behet sipas normave te meposhtme:

Gjate jetes:

Ne se nje ortak mendon te leshoje te gjitha kuoten qe posedon ose pjese te saj, ai duhet te jape komunikim me shkrim me indikacionet perkatse te cmimit dhe emrin e bleresit te kuotes.

Shoqeria u jep menjehere kopjen e vendimit ortakeve te tjere, te cilat kane te drejte te marrin pjese ne blerjen e kuotave sipas pergindjes qe ka ne kuote, ne menyre qe kushtet e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise te mos ndryshojne, por mund te veprohet edhe ndryshe kur prej tyre lejohet ndryshimi i raportit te kuotave.

Ortakët kane te drejte qe brenda periudhes taksative, prej 3 muajsh nga data qe kane marre komunikim me shkrim per shitjen e kuotave te venede ne dijeni shoqerine nese jane dakord ose jo per blerjen e tyre.

Nese ortaku nuk u pergjigjet brenda afatit te lartpermendur automatikisht nuk merr pjese ne blerjen e kuotave.

Nese pas tre muajsh pas komunikimit ortakët nuk lajmerojne pjesemarrjen e tyre, atehere ortaku tjetër ka te drejte t'ia shese kuotat e tyre personave qe mendon ai si dhe me cmimin e vendosur midis tyre. Ne qofte se cmimi i shitjes se kuotes kundërshtohet nga ortakët atehere vleresimi behet nga nje ekspert, i cili zaktohet nga gjykata me procedure urgjente dhe me vendim te formes se prere.

Ne rast vdekje te ortakeve kuotat e tyre u kalojne trashegimtareve te tyre. Keta vendosin per likuidimin e kuotes ose per vazhdimin e veprimtarise duke respektuar kerkesat e nenit 46 te ligjit per shoqerite

O R G A N I Z I M I

Neni 9

Organet drejtuese te shoqerise jane asambleja e ortakeve dhe administratori.

A S A M B L E J A

Neni 10

Asambleja perfaqeson bashkesine e ortakeve. Vendimet e saj te marra konforme ligjit dhe statutit te shoqerise jane te detyrueshme per ortaket dhe te punesuarit ne kete shoqeri.

Neni 11

Asambleja zhvillon mbledhje te zakonshme dhe te jashtezakonshme. Ajo mund te thirret ne mbledhje edhe jashte vendodhjes se shoqerise. Asambleja mblidhet nje here ne vit, si rregull ne fund te vitit, me vendim te administratorit ajo mund te mblidhet edhe gjashte muaj para mbylljes se aktivitetit vjetor.

Neni 12

Çdo ortak ka nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar.

Neni 13

Thirrja e Asamblese behet ne kujdesin e administratorit me leter rekomande te pakten pesembedhjete dite para mbledhjes.

Neni 14

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjen e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarta me numrin e kuotave qe ai zotero.

Neni 15

Çdo ortak ne mbledhjen e asamblese mund te perfaqesohet nga nje person tjetër me ane te nje kerkese me shkrim. Nje ortak nuk mund te narkoj nje mandat. Bajtes te volje ne emer te nje pjese te kuotes duhe votuar si vote ne emer te pjeses tjetër.

Neni 16

Asambleja drejtohet nga njeri prej ortakeve i zgjedhur prej saj dhe i nenshkruan dhe procesverbalin e mbledhjes se asamblese.

Neni 17

Asambleja e zakonshme mblidhet rregullisht kur eshte e pranishme me shume se gjysma e kuotave te kapitalit themeltar. Ajo merr vendime me shumice absolute.

Asambleja e jashtezakonshme, e cila ka dhe te drejten e ndryshimeve n statut kur jane da ord tre te katertat e kapitalit themeltar.

Neni 18

Ne asnje rat nuk mund te detyrohet nje ortak per te rritur ose pakesuar angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

A D M I N I S T R I M I

Neni 19

Shoqeria administrohet nga administratori i zgjedhur nga asambleja, i cili qendron ne drejtim deri ne fund te afatit te shoqerise.

Neni 20

Administratori ka te drejte te kryeje cdo akt qe e gjykon te arsyeshme dhe konforme ligjit per arritjen e qellimit te shoqerise.

Ai eshte i autorizuar te kryeje cdo operacion prane zyrave publike e private. Ka te drejten e emerimit te perfagesuesve dhe te punonjesve te tjere duke respektuar ligjin. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe kane bere marreveshjen per te perballuar individualisht ose solidarisht demin qe kane shkaktuar.

Neni 21

Per perfagesimin e shoqerise perpara organeve administrative, gjyqesore ose te treteve duhet deklarim me shkrim nga administratori.

Neni 22

Ne rast pengesash si semundje te gjata, udhetime jashte shtetit etj, te administratorit, asambleja zgjidh ceshtjen e drejtimit te perkohshem te shoqerise.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 23

Veprimtaria ekonomike e shoqerise celet me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Neni 24

Eshte e drejta e asamblese te vendose per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe per perorimin e tyre.

Neni 25

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ndahen midis ortakeve sipas pakuotave te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar.

SHPERBERJA

Neni 26

Duke gene se ne cdo kohe dhe per cdo lloj motivi shoqeria mund te gjendet perballe shperberjes asambleja e ortakeve rregullon menytrat e likuidimit dhe emerone nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar atyre fuqite qe kane.

Neni 27.

Likuidatoret pergatisin bilancin i cili miratohet nga asambleja. Shoqeria i jep fund veprimtarise ne momentin e miratimit te bilancit te likuidimit. rasurget ne dispozicion te shoqerise qe jane marre me te drejte shfrytézimi u kthehen pronareve. asetet financiare dhe gjithë pasuria e shoqerise pasi jane bere likuidimet dhe pagesat e ndryshme per kreditoret ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat ne kapitalin themeltar.

Neni 28

Statuti u perpilua ne 4 kopje me fuqi te barabarte per t'u administruar ne organet gjyqesore dhe ato tatimore, ndersa nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "KOVUDA" SHPK.

Statuti i miratuar nga ortaket nenshkruhet rregullisht prej tyre.

ORTAKET

Dhimiter Kolovani

Muharrem Muredini

Dhame Daka

[Signature of Dhimiter Kolovani]

[Signature of Muharrem Muredini]

[Signature of Dhame Daka]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTERIA E DREJTESISE
NOTERIA

8227

NR _____
5308

REPUBLIKA

Sot me daten

1994 u paraqiten ne zyren e noterise

Dhimiter Kolovani, Muharrem Muredini, Dhame Daka, madhore me zotesi te plerjuridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurua nga leter njeftim e tyre personale, te cilet me deklaruan se sa siper eshte nje statut-kontrate e hartuar jashte kesaj zyre me vullnetin e plote te tyre dhe nenshkruhet rregullisht, ndersa une noteria vertetoj ate sipas ligjit.




[Handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 5030

VERTETIM


Sot me date 29 .06.2005, para meje noterit publik , me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.Muharrem Nuredini shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "KONUDA" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.



Noteri

Milindus Meksi

Shey



4071/3

S B Mues
01 KORIK 2005
Berat, me 10.06.2005

SHOQERIA TREGTARE "KONUDA" SH.P.K

KERKESË



Kerkuesi: Shoqeria tregtare "KONUDA" sh.p.k, perfaqesuar nga administratori z.Muharrem Nuredini.

Objekti: Depozitimi ne regjistrin tregetar te vendimit nr.2, date 10.06.2005, te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve "KONUDA" sh.p.k.

*Be depoziti te ket
kerkeses dt*

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

05.07.05

Z. Kryetar!

Shoqeria "KONUDA" sh.p.k, eshte rregjistruar si person juridik ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me vendim nr.4071, date 13.05.1994.

Asambleja e Ortakeve, me vendimin nr.1 date 01.06.2005 vendosi per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise dhe i kerkoj gjykates caktimin e nje eksperti kontributesh.

Ne baze te kerkeses se mesiperme, Gjykata e Shkalles se Pare Tirane, me vendim nr.4071/2, date 06.06.2005, pranoi kerkesen dhe caktoi si ekspert kontributesh z. Dhimo Dundo i cili paraqiti prane shoqerise sone raportin per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

Me vendimin nr.2 date 10.06.2005, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve, aprovoj raportin e ekspertit dhe vendose per zmadhimin e kapitalit themeltar dhe depozitimin e vendimit te tij ne gjykatën e regjistrit.

Bashkengjitur kesaj kerkese po ju paraqesim:

- Vendimin nr.2 date 10.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "KONUDA" sh.p.k.
- Raportin e Ekspertit te Kontributeve dhe bilancin e riformuar.

Mues
05.07.05
Raport eksp.
+ Bilancin
Referuar

ADMINISTRATORI I SHOQERISE TREGTARE "KONUDA" SHPK

Muharrem NUREDINI

REPubLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. SP10

VERTETIM

Sot me date 27 .06.2005, para meje noterit publik , me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.Muharrem Nuredini shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "KONUDA" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.



Noteri
Muharrem Nuredini
Rex

**SHOQERIA TREGTARE "KONUDA" SHPK
ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E ORTAKEVE**

VENDIM

Nr. 2 date 10.06.2005



Sot, me date 10.06.2005, Asambleja e Jashtezakonshme e shoqerise tregtare "Konuda" sh.p.k, e cila eshte e rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, nr 4071 date 13.05.1994, e bazuar ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne statutin e shoqerise, pasi u njoh me raportin e ekspertit te kontributeve, i kerkuar prej saj dhe e miratuar nga gjykata me vendimin nr 4071/2 date 06.06.2005

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit te ekspertit te kontributeve z Dhimo Dundo, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 34.220.000 leke, nepermjet perfshirjes se fitimeve te mbartura, fitimit te ushtrimit dhe rezervave te tjera, te paraqitura ne llogarite vjetore te ushtrimit 2004. Shtesa e kapitalit themeltar ndahet ne 34.220 pjese me vlere nominale te barabarte 1.000 leke secila, aq sa ka qene ne vlera nominale e pjeseve ekzistuese.
3. Pjeset e reja do te perfitohen nga ortaket ne perpjestim me te drejtat e meparshme dhe perkatesisht nga, z. Muharrem Nuredini 17.110 pjese ose 17.110.000 leke dhe z Dhame Daka 17.110 pjese ose 17.110.000 leke.
4. Shtimin e rezerves ligjore me 5% te fitimeve te pashperndara ose 1.001.935 leke.
5. Ndryshimin e nenit 7-te te statullit te shoqerise qe tani lexohet si me poshte:
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 34.320.000 leke, i ndare ne 34.320 pjese me vlere nominale 1.000 leke secila dhe zoterohet nga ortaket:
 - Muharrem Nuredini, zoteron 17.160 pjese kapitali e barabarte me 17.160.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
 - Dhame Daka, zoteron 17.160 pjese kapitali e barabarte me 17.160.000 leke, ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
6. Depozitimn e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar.

ORTAKET E SHOQERISE TREGTARE "KONUDA" SHPK

Muharrem NUREDINI

Dhame DAKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR. 5030

VERTETIM

Sot me date 4 .06.2005, para meje noterit publik , me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.Muharrem Nuredini DHE Dhame Daka shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakeve te shoqerise "KONUDA" sh.p.k, te cilet me deklaruan se dokumentin e mesiperme ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

Noteri

Mirzaq Mehmet

Elmy



4071/2

JB Mujes

3 QERSHOR 03 06 2005

KERKESE

KERKUESI : z. MUHARREM NUREDINI, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise "KONUDA" sh.p.k

Objekti : Depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr 1, date 01.06.2005 te Asamblese se ortakeve shoqerise "KONUDA" sh.p.k

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Me vendimin nr. 4071, dt. 13.05.1994 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "KONUDA" sh.p.k me ortak Muharrem Nuredini, Dhimiter Kolovani dhe Dhame Daka, me administrator Dhimiter Kolovani

Me vendimin nr.4701/1, date 19.03.2003 nga kjo shoqeri largohet z. Dhimiter Kolovani dhe shoqeria "KONUDA" shpk mbetet me dy ortak Muharrem Nuredini dhe Dhame Daka, me kuota te barabarta secili nga 50% dhe me administrator z.Muharrem Nuredini, me seli ne Berat.

Me vendimin nr.1 te Asamblese se Ortakeve date 01.06.2005 eshte vendosur:

1. Te caktojme si ekspert kontabel te autorizuar z. Dhimo Dundo me numer license nr.8, date 11.01.2000 per shtesen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise.
2. Depozitim e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkoj depozitim e ketyre ndryshimeve prane regjistrin tregtar.

KERKUESI
MUHARREM NUREDINI

DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR.3681 REP.

VERTETIM

Sot me date 02.06.2005, para meje noterit publik, me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.MUHARREM NUREDINI, shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "KONUDA" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperme ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noterit e vertetoj ate sipas ligjit.



Notere
me 1 rano me

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGETARE "KONUDA" sh.p.k.

V E N D I M
I M B L E D H J E S E J A S H T E Z A K O N S H M E T E A S A M B L E S E S E O R T A K E V E

NR. 1, DATE 01.06.2005


Sot ne mbledhjen e dates 01.06.2005, ne ortaket e shoqerise "KONUDA" sh.p.k. morem ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj ne te ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin

V E N D O S E M :

1. Te caktojme si ekspert kontabel te autorizuar z. Dhimo Dundo per shtesen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .
2. Depozitimim e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.


O R T A K E T
MUHARREM NUREDINI DHAME DAKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 3681



V E R T E T I M

Sot me date 02.06.2005, para meje noterit publik me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.MUHARREM NUREDINI dhe Dhame Daka shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "KONUDA" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.



4071/1
19-05-02
K E R K E S E

g A Copo
14 03 2002
14 MAR. 2002

KERKUESIT: 1. Dhimitër Kolovani, i biri i Llambit, i dt. 1944, lindur në Berat dhe banues në Tiranë.
2. Dheme Daka, i biri i Sotirit, i dt. 1949, lindur dhe banues në Berat.
3. Muharrem Nuredini, i biri i Dines, i dt. 1947, lindur dhe banues në Berat.

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimit Nr. 2, dt. 27.02. 2002, të Asamblese të Shoqërisë Tregtare Private Ndërtuese "KONUDA" Sh.p.k. Berat për ndryshime në Statutin dhe Kontraten e Themelimit të Shoqërisë në baza të ligjit 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtare".

GJYKATËS SE RRETHIT
TIRANË

Me Vendimin e saj Nr. 2, dt. 27.02.2002, Asambleja e Zakonshme e Shoqërisë Ndërtuese "KONUDA" Sh.p.k. Berat vendosur ndryshimet në statutin e Shoqërisë, në aktin e themelimit të saj duke bërë ndryshime në pjesët e kapitullit të themelimit dhe në administratorin e shoqërisë. Kështu, pjesët e kapitullit të themelimit u tekojnë në mënyrë 50% ortakut themelues Muharrem Nuredini dhe 50% ortakut Dheme Daka.

Administratori i Shoqërisë "KONUDA" Sh.p.k. Berat është emëruar Muharrem Nuredini.
Për sa më sipër me qellim që të bëhen ndryshimet përkatëse edhe në regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë në këte shoqëri kërkohet depozitimi i Vendimit të mësipërme të Asamblese të Shoqërisë sonë.

Pa më sipër bashkëlidhim edhe dokumentet përkatëse.

K E R K E S I T

Dhimitër Kolovani

Dheme Daka

[Signature]

[Signatures]

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
SHOQËRIA NDËRTUESE "KONUDA" SHPK

B E R A T

V E N D I M

Nr: 2, dt. 27.2.2002

I ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE SHOQERISE "KONUDA" SHPK BERAT

Indiv. C. nde. J. Sot, më 27.2.2002, në Berat, Asambleje e Zakonshme e Shoqerise "Konuda" Shpk Berat, si themelues nga zoterinjtë: Dhimiter Kolovani; Muharrem Nuredini dhe Dhame Deka, me pjesë të barabarta në kapitalin e shoqerise dhe e regjistruar, si person juridik, me Vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës Nr: 4701, dt. 19.05.1994,

V E N D O S I

1. Përdimin e shitjes së pjesës së kapitalit themelues që zoterohet nga orteku Dhimiter Kolovani në 1/3 e kapitalit gjithsej ose në vlerë absolute 33.333 leke dhe blerjen e kesaj pjesë nga orteket Muharrem Nuredini 16.666 leke (dhe Dhame Deka 16.667) leke, sipas aktit noterial të shitjes me nr: 640/137, dt. 27.02.2002.

2. Lërgimin nga Shoqëria e ortekut Dhimiter Kolovani, duke qenë se të gjithë pjesën që si zoteronte në kapitalin e Shoqërisë "KONUDA" ishi shiti orteku Muharrem Nuredini dhe Dhame Deka në pjesë të barabarta, të cilët me këtë blerje behen orteket e vetëm të shoqërisë me pjesë të barabarta në kapital themelues të shoqërisë.

Për këtë të behen ndryshime në nenin 1 të statutit.

3. Ndryshimin e nenit 7 të Statutit të Shoqërisë që tani lexohet si më poshtë: Kapitali i shoqërisë është 100.000 leke dhe i ndare në 100 pjesë. Pjesët e tij zoterohen nga orteket: 3/a. Muharrem Nuredini 50 (pesëdhjetë) pjesë ose 50% të kapitalit themelues të shoqërisë.

3/b. Dhame Deka 50 (pesëdhjetë) pjesë ose 50% të kapitalit themelues të shoqërisë.

4. Emerimin e administratorit të shoqërisë të z. Muharrem Nuredini, pasi administratori i mëparshëm z. Dhimiter Kolovani ka dhënë dorëheqjen. Ndryshimin e nenit 19 të statutit, dhe nenin 8 të kontratës themelimit.

5. Depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar.

ORTAKET E SHOQERISE "KONUDA" Shpk me seli në BERAT

Dhimiter Kolovani
Muharrem Nuredini
Dhame Deka

K O N T R A T E S H I T J E



Sot, më 27.2.2002, para meje noterës Natasha Dervishi në Berat, u paraqitën personalisht palët kontraktuesë:

1. Dhimiter Kolovani, i biri i Llambit, i dt. 1942, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me cilësinë e shitësit.

BLERËSAT: 1. Muharrem Nuredini, i biri i Dines, i dt. 1947, lindur dhe banues në Berat.

2. Dhame Daka, i biri i Sotirit, i dt. 1949, lindur dhe banues në Berat.

Palët, me zotësi të plotë juridike për të vëpruar, të njohur personalisht prej meje noterës, të cilët me dëshirën dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe cilësinë e ortakëve të Shoqërisë "KOMUDA" Shpk Berat, lidhën Kontraten e Shitjes së më-poantë vijon:

Shitësi Dhimiter Kolovani në bazë të kontratës së Themelimit dhe të Statutit të Shoqërisë "KOMUDA" Shpk Berat ka në pronësi të tij 1/3 e kapitalit themeltar gjithsej në këtë shoqëri ose "në vlefë absolute 33.333 lekë, ndërsa blerësat e mësipërme kanë në pronësi të tyre 2/3 e këtij kapitali themeltar, gjë që vertetohet në bazë të Vendimit Nr.4701, datë 13.05.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Shitësi Dhimiter Kolovani, si ortak i kësaj shoqërie të mësipërme deklaroi se i shet blerësve Muharrem Nuredini dhe Dhame Daka në pjesë të barabarta 1/3 e kapitalit themeltar që ka në pronësi të tij, pra, teresisht pjesën e tij takuese të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie, kundrejt shumës prej 33.333 lekë gjithsej.

Nga ana e tyre blerësat e mësipërme deklarojnë se janë dakort që të blejnë teresisht kuotat e kapitalit të themelimit të Dhimiter Kolovanit si më sipër, në pjesë të barabarta, duke marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga veprimi i mësipërme juridik.

Palët deklarojnë se është bërë likuidimi i plotë i të gjithë shumës së përgjithshme prej 33.333 lekë nga blerësat, në pjesë të barabarta sipas kësaj kontrate.

Pra, palët deklarojnë se janë të likuiduar plotësisht me njëri-tjetrin.

Me këtë shitje shitësi Dhimiter Kolovani zhvishet nga pronësia e mësipërme.

Kështu, nga momenti i nënshkrimit të kontratës nga palët dhe noterimit të kësaj **BLERËSAT: MUHARREM NUREDINI dhe DHAME DAKA** bëhen bashkëpronarë në pjesë të barabarta të kapitalit themeltar të shoqërisë Ndertuese "KOMUDA" Shpk Berat prej 100.000 lekësh (njëqinda mijë) lekësh, duke i takuar secilit prej tyre në pronësi nga 50% e këtij kapitali themeltar të kësaj shoqërie.

Sa më sipër u lexua dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

Udhënoterja e vertetohet me rregullisht konform ligjit.

P A L E T K O N T R A K T U E S E

Dhimiter Kolovani *[Signature]*

Notere
(Natasha Dervishi)

Dhame Daka

Muharrem Nuredini *[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
NOTERE NATASHA DERVISHI, BERAT
Nr. 642/139



DEKLARATE NOTERIALE

Sot, më 27.2 2002, para meje Noteres Natashë Dervishi në Berat, u paraqiten personalisht deklaruesit: - - - - -

1. Dhimiter Koloveni, i biri i Llembit, i dt. 1942, lindur në Berat dhe banues në Tiranë.
2. Dheme Deka, i biri i Sotirit, i dt. 1949, lindur dhe banues në Berat.
3. Muharrem Nuredini, i biri i Dines, i dt. 1947, lindur dhe banues në Berat.

Të lartepërmëndurit me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurove konform ligjës, me dëshirën dhe me vullnetin e tyre të lirë deklaruen para meje noteres si më poshtë vijon:

Te tre ne deklaruesit jemi ortakë themelues në Shoqërinë Private Ndertuese "KONUDA" Sh.p.k. Berat, gje që vertetohet me nën të Vendimit Nr. 4701, datë 13.05.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Deklarojmë se në baza të Vendimit të Asamblese të shoqërisë së datës 21.02.2002, unë Dhimiter Koloveni jem larguar nga kjo shoqëri duke dhënë dorëheqjen dhe në këtë shoqëri ngelen ortakë të vetem vetem Z.Z/ Muharrem Nuredini dhe Dheme Deka.

Deklarojmë të tre se nuk kemi më detyrime ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj shtetit që kanë të bëjnë me kapitalin e themelimit dhe veprimtarinë e kësaj shoqërie.

Deklarojmë se të gjithë veprimet dhe detyrimet ndaj njëri-tjetrit janë kryer realisht dhe ndaj njëri-tjetrit nuk ekziston më asnjë detyrim.

Se më sipër e deklaruem me dëshirën dhe me vullnetin tonë të lirë dhe pasi e lexuem e nënshkruajmë rregullisht.

Ky akt si u pa i njëjtë me dëshirën dhe me vullnetin e palëve dhe konform ligjës vertetohet rregullisht edhe prej meje noteres.

DEKLARUESIT

Dhimiter Koloveni *[Signature]*

Dheme Deka *[Signature]*

Muharrem Nuredini *[Signature]*

Notere
(Natasha Dervishi)

[Signature]

K E R K E S E


PER RIREGJISTRIMIN E FIRMES SI
PERGJEGJESI TE KUFIZUAR



GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Muharrem Nuredimi, i datelindjes 1947,
Dhimiter Kolovani, i datelindjes 1943
Dhame Daka, i datelindjes 1949



Meqe kerkesa per rivendosjen ne afat na u miratua nga ana juaj
Nr. 852 date 11.05.1994 ju drejtohem juve si gjykate kompetente
dhe kerkojme qe firma jone "KONUDA" e regjistruar si person juridik
me vendim nr 176/1 date 8.9.1993 e gjykates sarrethit Berat, te riregjis-
trohet si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "KONUDA" SHPE ne
beze te ligjit 7638 date 19.11.1992 " per shoqerite tregtare"

Objekti i vepramtarise eshte: punime dheu, murature, betoni, b/arm
te zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile, industriale, turistike
bujesore e kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime restauri-
mi, punime te shtresave te rrugeve, ujesjellesa, kanalizime, mirembajtje
e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal,

Shoqeria ka nje kohegjatje mbi 10 vjet te veprimtarise se saj.
Ajo e ka seline ne Berat , lagja 30 vjetori. Administratori i saj eshte

Administratori dhe ortakët janë kompetentë që janë shtjelluar në
kontraten dhe statutin e shoqerise te cilet i janë bashkangjitur kerkese

*Te regjistruar
dt. 13.05.1994
9877*

KERKUESIT

Dhimiter Kolovani
Muharrem Nuredimi
Dhame Daka

tirone, me 26.4.1994